



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 9011/11 prot.

Himarë, më 17.12 . 2025

**Lënda:** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak Himarë.

**Të nderuar këshilltarë,**

Ju njoftojmë se ditën e hënë më datë 22.12.2025, ora 10:00 në sallën “Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin dhjetor të Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Mbledhja do të ketë këtë rend dite.

Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2026”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për themelimin e shoqatës sportive jofitimprurëse “Klubi i Sportit Himara”, Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për propozimin për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-30 nëntor 2025, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike;
7. Të ndryshme.



**Sekretari**

**Zaho Dedi**